

I. Çfarë është Sigurimi i Jetës (me Mbijetesë)?

Sigurimi i Jetës (me Mbijetesë) është një kombinim i sigurimit të jetës me një investim. Ky sigurim, përveç sigurimit të jetës së personit, ndihmon të siguroarin të kursejë rregullisht ,për një periudhë të caktuar kohe. Sigurimi garanton një shumë monetare (Shuma e siguar) e cila është e pagueshme në rast vdekje apo mbijetesë.

Shumën e Sigurimit, që e merrni në fund të periudhës së policës, mund ta përdorni pa kufizim për çfarë të dëshironi: të ngrini një biznes të ri, të shkolloni fëmijët, të blini një shtëpi të re, të financoni të ardhurat tuaja për pension, etj.

Në rast se personi i siguar, ndërron jetë gjatë periudhës së policës, pasardhësit e tij (fëmijët, bashkëshorti/ja) përfitojnë shumën e sigurimit menjëherë, duke patur kështu një mbrojtje financiare.

II. Kujt i shërben një sigurim i tillë?

A. Për individët

Ky sigurim është i përshtatshëm kryesisht për individët që kanë të ardhura fikse mujore, të cilët pas një periudhe 10, 15, apo 20 vjetësh, do iu duhet të kenë gati një shumë parash për një objektiv të caktuar. Pikërisht, ky lloj sigurimi siguron që të keni fondin tuaj gati, kur t'ju duhet.

Për çdo individ, ky sigurim ofron:

1. Arritje të objektivave të kursimit
2. Ngritja e një fondi për të përmbushur në afatgjatë një objektiv të caktuar investimi
3. Mbrojtje financiare për pasardhësit (familjen)

B. Për Punëdhënësit

Ky produkt, nëpërmjet kartës “Motivim +”, paraqet një opsion mjaft interes për punëdhënësit, si pjesë e politikave për përfitimet e punonjësve dhe motivimin e tyre, si dhe administrimin më të mirë të lëvizjeve të stafit. Vetë punonjësit ndjehen të incentivuar për të zgjatur periudhën e punësimit pranë këtij punëdhënësi, pasi do të mund të përfitojnë shumën e garantuar vetëm nëse do të qëndrojnë të punësuar për të gjithë periudhën e sigurimit.

III. Avantazhet e Sigurimit të Jetës (me Mbijetesë)

1. Ju ndihmon të administroni më mirë të ardhurat tuaja.
2. Ju ndihmon të kurseni rregullisht.
3. Shuma e sigurimit garantohet që në fillim dhe mund të tërhiqet menjëherë në datën e maturimit.
4. Ofron mbështetje dhe siguri financiare për familjen tuaj.
5. I siguruari ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimin që kompania siguroese realizon nga investimi i primeve për këtë kategori.

IV. Përse të merrni këtë policë sigurimi nga SiCRED?

Një Policë - me 3 sigurime!

Me të njëjtën policë siguroheni për jetën, aksidentet, dhe sëmundjet kritike. Bashkë me sigurimin e Jetës (me mbijetesë), mund të zgjidhni dhe sigurimet shtesë:

- **Sigurim nga Aksidentet** – nëpërmjet këtij sigurimi, përfitoni të drejtën për përfitim në rast të ndodhjes së aksidenteve, duke marrë dëmshpërblim në rast paaftësie të përhershme dhe të përkohshme, shpërblim ditor për ditët e paaftësisë, etj.
- **Sigurim nga Sëmundjet Kritike**– nëpërmjet këtij sigurimi, përfitoni të drejtën për përfitim në rast të shfaqjes së një prej sëmundjeve kritike (sëmundje të rënda), gjatë periudhës së sigurimit. Kështu, ju do të keni të ardhura të mjaftueshme për të përballuar kurimin tuaj, pa vënë në rrezik planet tjera financiare tuajat dhe të familjes.